Project: Date ...... / ...... / ..52..

# Protokoll Nr 2

Protokolli mbahet sot me datë 27.02.2026, ora 10.00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Divjakë, kati i dytë në godinën e Bashkisë, për zhvillimin e mbledhjes së radhës së K.B. për muajin Shkurt 2026.

Në mbledhje marrin pjesë Këshilltarët:

Xiri Bili, Ardian Vodo, Tatjana Budani
Blerim Daiughi, Alketa Canaku,
Juljan Vrapi, Shpëtim Sheshi
Indrit Zgjani
Mjete Nebelli, Gojart Apolli
Roza Troshku, Elizabeta Rredhi
Majlinda Xhano, Mishel Verdha
Sokol Koloshi, Antuela Gjini
Xili Bili, Adelajda Culi

Megjithëse u plotësua kuorumi i pjesëmarrjes në mbledhje, Sekretarja e Këshillit të Bashkisë Divjakë e deklaron mbledhjen e radhës për muajin Shkurt të hapur dhe kalon tek:

Rendi i ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 27.01.2026.
3. Informacion mbi zbatimin e VKB për muajin Janar 2026.
4. Projektvendim për themelimin e Shoqatës sportive jofitimprurëse "Klubi sportiv Arnisa, miratimin e Aktit të themelimit dhe Statutit.
5. Projektvendim për pakësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në Buxhetin e Bashkisë Divjakë për v. 2026 nga të ardhurat e trashëguara (Kapitulli 01)
6. Projektvendim për miratimin e riemërtimit të projektit të investimit në Buxhetin e v. 2026
7. Projektvendim për miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2026.
8. Projektvendim për pakësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e B. Divjakë për v. 2026 nga financimet e huaja.
9. Projektvendim për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Janar 2026
10. Projektvendim për miratimin e bashkëfinancimit për

Project: Date ...... / ...... / ..........

"Projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese, për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara për vitin 2026.

11. Projektvendim për miratimin e tarifës së ushqimit të kopshtit me dreke nga Bashkia Divjakë për fëmijën e z. Landi Beno.

12. Projektvendim për miratimin e Raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave në Bashkinë Divjakë për vitet 2027 - 2029.

13. Projektvendim për ndryshime të VKB nr 90 dt. 29.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Divjakë, Nj. Adm. dhe Institucioneve në vartësi për vitin 2026.

14. Projektvendim për miratimin e një shtese në Buxhetin e vitit 2026 nga të ardhurat e trashëguara nga v. 2025.

15. Projektvendim për dhënien e ndihmës financiare për fermerët që kanë pësuar dëme nga përmbytjet J-Sh. 2026

16. Projektvendim për një ndryshim në VKB nr 90 dt. 29.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonj. B. Divjakë

17. Projektvendim për miratimin e nr të punonjësve me kontratë të përkohshme për v. 2026 në Bashkinë Divjakë.

18. Projektvendim për transferimin e fondeve nga Buxheti i Bashkisë në shoqërinë "Ryelo" Shpk.

19. Shqyrtim i kërkesës së Sekretarit të Bashkisë për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit, të SKB për shkak të plotësimit të moshës së daljes në pension.

1. Pika e parë e rendit të ditës.
- Miratimi i rendit të ditës.

Sekretarja znj. Lin Bitri i drejtohet këshilltarëve: Para se të miratojmë pikën e parë të rendit të ditës, a keni pyetje apo diskutime për rendin e ditës.
Merr fjalën Sekretarja e Komisionit të Ekonomisë dhe financave dhe propozoj shtesë në rendin e ditës për projektvendimin e paraqitur nga Bashkia me nr 24 i prot. me nr 1480/6 datë 23.02.2026 "Për miratimin e një rishpërndarje fondesh në Buxhetin e vitit 2026. Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka, shtesa apo plotësime të tjera s'ka.
Hidhet në votim pika e parë e rendit të ditës së Bashkisë me propozimin shtesë të projektvendimit dhe që të renditet në pikën 20 të rendit të ditës dhe votohet me

18 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

2- Pika e dytë e rendit të ditës

- Miratim i procesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 27.1.2026.

Pyetje në lidhje me procesverbalin e mbledhjes s'ka. Diskutime nga këshilltorët s'ka.

Hidhet në votim pika e dytë e rendit të ditës dhe votohet me 18 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

3- Pika e tretë e rendit të ditës.

- Informacion mbi zbatimin e VKB Divjakë për muajin Janar 2026.

Pyetje për informacionin nuk ka, diskutime s'ka.

Kryetarja e këshillit znj. Xin Biti i jep fjalën për relatim kryetarëve të komisioneve për Raportet e shqyrtimit të projektvendimeve në mbledhjet e komisioneve.

Lexoj Raportin e Komisionit të Ekonomisë dhe financave znj. Tatjana Budani e cila shprehet: Komisioni vendosi që të kalojnë për miratim projektvendimet 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24. ku pasi i shqyrtoi një për një të gjitha projektvendimet e mësipërme përveç projektvendimit Nr. 20 u votuan nga anëtarët e komisionit me 4 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim, dhe projektvendimi Nr 20 u votua me 3 votë pro dhe 1 votë kundër.

Lexon Raportin e Komisionit të Bujqësisë dhe Emergjencave civile, Kryetari i Komisionit z. Suplatin Sheshi i cili shprehet se më datë 25.2.2026, Komisioni u mblodh, shqyrtoi projektvendimin për dhënien e ndihmës financiare për fermerët që kanë pësuar dëme nga përmbytjet e muajve Janar-Shkurt 2026 dhe vendosi që të kalojë për miratim në mbledhje.

4- Pika e katërt e rendit të ditës.

- Për themelimin e shoqatës sportive jofitimprurëse "Klubi Sportiv Divjaka, miratimin e Aktit të themelimit dhe Statutit.

Znj. Xin Biti diskuton mbi projektvendimin e kësaj pike duke pyetur juristin Andi Ballon: A e pengon këshilltorin nen 12 pika (a) i cili është pjesë e Aktit të themelimit të shoqatës dhe sekretar i Bordit drejtues i kësaj shoqate. Na e interpreto, sepse këtu në këtë nen citohet: Anëtari i këshillit bashkiak nuk përjashtohet në një procedurë shqyrtimi dhe vendimmarrëse në rastet kur

Project: Date ...... /...... / ..........

a) ka një interes personal të drejtë për drejtë ose jo të drejtë për drejtë në vendimmarrjen në shqyrtim, konflikt interesi?
Juristi z. A. Bullari nuk i jep përgjigje të saktë, të përgjithshme.
Në këtë moment edhe këshilltari z. Ardian Vodo, i cili kërkon fjalën, Kryetarja zj. Lini Bitri i jep fjalën:
Ngjet Tek ky bordi drejtues a mund të jem dhe unë si këshilltar dhe si mjek, për profesionin që kam: Përgji-gjet Kryetari i Bashkisë: Po, mund të jeni, një 3 anëtarë mund të bëhen dhe 5 anëtarë në këtë bord drejtues.
Zvj. Lini Bitri: Propozoj dhe unë që në Bordin Drejtues të jetë edhe z. Fotjon Lena dhe Antuela Gjini.
z. Indrit Zyrona: Zonja Kryetare: Ja ju them se Këshilltari ka konflikt interesi dhe tani po e propozoni për anëtar të Bordit drejtues.
z. Shpetim Sheshi: Në mbledhjen e Kryesisë në vendosëm rendin e ditës dhe mendoj se tani në vendimmarrje Këshilltari nuk do të marrë pjesë në votim, por përjashto-het nga votimi në këtë rast, nuk voton për vetëm e vet.
z. Ardi Bullari juristi i propozon këshilltarëve që kjo Shoqatë të emërtohet "Klubi Sportiv 'Arnisa 1'" dhe Bordi drejtues të jetë me 5 anëtarë: 1- Euro Arosa Kryetar, Indrit Zyrona sekretar, Lirim Dedej anëtar, Ardian Vodo anëtar, Fotjon Lena anëtar.
z. Blerim Dauidhi: A është krijimi i shoqatës ligjore? Sqaron Juristi z. A. Bullari: Është shoqatë jofitimprurëse.
z. Shpetim Sheshi: Kam mendimin se Bordi drejtues zgjidhet nga Asambleja e përgjithshme.
z. Lili Bitri: Ç'të keqe ka që këshilltari të përfshihet në Bordin e kësaj shoqate?
z. Blerim Dauidhi: Zyrat e shoqatës do të jenë në godinën e Bashkisë? Përgjigjet z. A. Bullari: Është menduar për ndërtimin e një godine të veçantë për këtë shoqatë.
Ngjet e diskutime të tjera s'ka.
Hidhet në votim pika e katërt e rendit të ditës dhe votohet me 16 vota pro, asnjë votë abstenim dhe asnjë votë kundër.
5. Pika e pestë e rendit të ditës.
- Për plotësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në Buxhetin e Bashkisë Divjakë për vitin 2026, një të

ardhurat e trashëguara (kapitulli 1)
Në këtë pikë relaton Drejtori i financës dhe buxhetit ku i propozon këshilltorëve pakësimin e të ardhurave në buxhetin e B. Divjake për v. 2026 nga të ardhurat e trashëguara.
Pakësimi në të ardhurat dhe shpenzimet e buxh. v. 2026 vjen si rezultat i një parashikimi më të lartë në vlerën 3.055.526.03 për të ardhurat e trashëguara në kap. 01. Pakësimi në shpenzimet e planifikuara do të jetë në progr. 01110, llog. 602, kap. 01, shpenzime të cilat do të kompensohen në projektbuxhetin për shtesën e buxhetit nga të ardhurat e trashëguara nga kapitulli 05. Në total parashikimi i të ardhurave të trashëg. nga viti 2025 në v. 2026 (01+05) është brenda vlerës që kemi parashikuar dhe miratuar në buxhetin e v. 26.
Diçka tjetër nga këshilltorët nuk ka, diskutime nuk ka.
Hidhet në votim pika e pestë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
6. Pika e gjashtë e rendit të ditës.
- Për miratimin e riemërtimit të projektit të investimit në buxhetin e v. 2026.
Relaton Drejtori i Financës dhe Buxhetit z. Xh. Brahkola ku i propozon këshilltorëve të miratojnë riemërtimin e projekteve të investimeve të miratuara me VKB nr 87 date 25.12.2025.
Emërtimet ishin. 1- Blerje binderi për shtrimin e rrugëve urbane B. Divjake v. 2026 2- Ndërtimi ndërtesa e Nj. Adm. Grabian. Gradishte. të bëhet 1- Blerje bindere (furnizim vendosje për shtrimin e rrugëve urbane, B. Divjake, viti 2026, 2- Rikonstruksion dhe ndërtim sotie për objektin ndërtesë e Nj. Ad. Gr.
Diçka tjetër s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e gjashtë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
7. Pika e shtatë e rendit të ditës.
- Për miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e v. 2026.
Relaton Drejtori i financës dhe buxhetit z. Xh. Brahkola dhe i propozon këshilltorëve të miratojnë një lëvizje fondesh nga Agjensia e Shërbimeve Komunale programi 06260 në programin 01110 Bashkia Divjake. Arsyeja që kërkohet kjo lëvizje fondesh është sepse Agjensia e Shërbimeve Komunale ka në strukturën e saj një nr të kufizuar punonjësish me arsim të lartë gjithsej 5 punonjës. Në ligjin 162/2020 neni 21 pika 5/1 "Për prokurimin publik përcaktohet se çdo ent, i cili në strukturën e tij organizative ka më pak se 15 punonjës do të veprojë si autoritet ose

Project: Date ...... / ...... / ..........

një kontraktor vetëm për kryerjen e prokurimeve me vlerë të vogël. Agjencia e Shërbimeve Komunale nuk e ka nr e punonjësve që kërkon ligji për të kryer procedurë prokurimi me vlerë mbi 1 milion lekë. Kryetarja i drejtohet këshilltarëve: A kemi pyetje apo diskutime për pikën e 7 të rendit të ditës?
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e shtatë e rendit të ditës dhe votohet me 18 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

8. Pika e tetë e rendit të ditës
- Për pakësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në Buxhetin e Bashkisë Shijak për vitin 2026 nga financimet e huaja.
Kryetarja znj. Xhin Bizi ia jep fjalën për relatim Drejtorit të Financës dhe Buxhetit z. Xh. Brahkola i cili i propozon këshilltarëve të miratojnë pakësimin e të ardhurave në Buxhetin e Bashkisë Shijak për v. 2026 të fondeve të planifikuara nga financimet e huaja për projektin e kombinuar të Bashkuara.
Vlera e të ardhurave të planifikuara në B. v. 2026 për projektin komb. të Bashkuara është 3.136.875 lekë. Pakësimi i të ardhurave të trashëguara nga projekti "Joinable" në vlerë 5000 lekë. Pakësimi në total e të ardhurave dhe shpenzimeve nga projektet e huaja në Buxh. e vitit 2026 do të jetë në vlerën 3,141,965 lekë. Vlera prej 5000 lekë më pak në zërin të ardhurat e trashëguara nga financimet e huaja projekti Joinable vjen si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit i cili ka sjellë një çelje fondi në Degën e Thesarit Kushtrie me 5000 lekë më pak.
Për sa i përket vlerës 3,136,875 lekë që do të zbritet në zërin financimet e huaja, pakësimi i të ardhurave dhe shpenzimeve nga financimet e huaja vjen si rezultat i mungesës së informacionit të saktë nga UNDP dhe aktorë të tjerë.
Në PBA 2026-2028 është mirëluar gjithashtu vlera prej 3.136,875 me kod 02 (financime të huaja) e cila do të përfshihej si e ardhur dhe si shpenzim për vitin buxhetor 2027. Duke u bazuar në saktësimin e mënyrës së financimit do të bëhen korrigjimet përkatëse në PBA 2027-2029 (?) pa...
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e tetë e rendit të ditës dhe votohet me 18 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

9. Pika e nëntë e rendit të ditës.
- Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Janar 2026.
Relatori Përgjegjësi i Sektorit të mirëqenies sociale dhe përkujdesit Shoqëror z. Ledio Muco, ku i propozon këshilltarëve të miratojnë familjet në nevojë të dala nga sistemi i pikëzimit me pikët e nevojshme dhe që kanë aplikuar ashtu si u është bërë dhe verifikimi në familje, të trajtohen me ndihmë ekonomike me fond deri 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Janar, 12 familje me fondin prej 59520 lekë.
Elisabeta Zeqi 10682 lekë, Hjerdita Lupo 5940 lekë, Esmeralda Gjata 7920 lekë, Vitrina Sila 5940 lekë, Irma Allajrami 1525 lekë, Alketa Meta 5227 lekë, Mimoza Krosniqi 2178 lekë, Zef Kolndreu 3703 lekë, Bashkime Gjini 1525 lekë Zegin Zegin 3703 lekë, Neim Dose 5227 lekë, Suzana Muçaj 5940 lekë
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e nëntë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

10. Pika e dhjetë e rendit të ditës.
- Për miratimin e bashkëfinancimit për projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të margjinalizuara për vitin 2026.
Kryetarja e KB znj. Lin Bita ia jep fjalën për relatim z. Ledio Muco, ku ky i fundit i propozon këshilltarëve të miratojnë listën e familjeve që kanë plotësuar kushtet ligjore dhe që përfitojnë nga ky projekt si më poshtë: Rajmonda Goliçi Divjakë, Lene Shkoza, Divjakë, Vasilika Berboti Divjakë, Marte Seko Divjakë, Ruan Halleshi Gungas, Fatos Muçaj Babunje e Re, Agron Hotjani Gungas, Haxhi Karafili Cermë e Sipërme, Zotmir Bajrami Gur, Marije Sotiri Xhanovaste, Hane Leka Remas.
- Të miratojnë kuotën e bashkëfinancimit nga Bashkia Divjakë të shprehur në % me 20% me vlerë 2,353,355.65 lekë për Projektin për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të margjinalizuara Divjakë 2026. - Të miratojnë fondin për mbikëqyrje të këtij projekti me vlerë prej 135,696 lekë. Të miratojnë fondin për kolaudim nga Buxheti i Bashkisë në vlerën prej 16,284 lekë.
Pyetje znj. Alketa Canaku: Nga k/j Adem Grabjaj, nuk ka,

Project: Date ...../...../........

asnjë familje? Nuk ka komunitete të varfëra me shtëpi të
rrezikuar në Grabjan? Përgjigjet Kryetari i Bashkisë z. J. Gorreja.
Ka disa kritere për përcaktimin e ndihmës sociale dhe
të rikonstruksionit të këtyre banesave. Kemi ngritur grupin
e punës dhe kemi konstatuar këto familje.
Znj. Alketa Çauku: Është një familje e Hurmas në Grabjan
problematika e shtëpisë së zonjës në fjalë nuk përfshihet
në këtë projekt.
Znj. Ajete Mebelli: Kemi dhe ne në Kryekuq si këto
raste, jo vetëm nuk kanë shtëpi por dhe një gjendje
ekonomike financiare jashtë shumë keq. Përgjigjet Kryetari
i Bashkisë: Po bashkëpunojmë me shtetin, me Dr. e fi-
nancës që të gjejmë fonde për të ndihmuar këto shtëpi.
Znj. Roza Broshka: Edhe unë shtroj problemin e Znj Hurma
në Grabjan.
Znj. Ajete Mebelli: Në Kryekuq është rast i veçantë me
aftësi të kufizuar është 4/familjen.
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë në përgjithësi dhe premton se
do të kërkojë fonde. Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e dhjetë e rendit të ditës dhe votohet
me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
11. Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.
- Për miratimin e tarifës së ushqimit të kopështit
me drekë për fëmijën e z. Laudi Beno.
Për këtë projekt vendim relatoi specialistja e arsimit
znj. N. Ndoni ku i propozoi këshilltorëve të miratojnë
miratimin e pagesës së tarifës së ushqimit të kopështit
me drekë në Bashkinë Divjakë të fëmijës së z. Laudi Beno
në kopështin Çamë Sektor për periudhën dhjetor 2025
- Nëntor 2026.
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e njëmbëdhjetë e rendit të
ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër
dhe asnjë votë abstenim.
12. Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.
Për miratimin e Raportit të vlerësimit dhe para
shikimit afatmesëm të të ardhurave në Bashkinë
Divjakë për vitet 2027-2029.
Relatoi znj. Alketa Hila Përgjegjëse pranë Drejtorisë

si Tekstrave dhe të ardhurave dhe i propozon këshilltorëve të miratojnë Raportin e vlerësimit dhe parashikimit Afatmesëm të të ardhurave në Bashki për vitet 2027-2029. Raporti përfshin vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për dy vitet e para të vitit buxhetor, vitin buxhetor, tre vitet e ardhshme buxhetore dhe Metodologjinë e përdorur për parashikimin afatmesëm të të ardhurave 2027-2029. Znj. Xin Bita A keni pyetje? Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

13. pika e trembëdhjetë e rendit të ditës.
- Për ndryshime të VKB nr 80 dt. 29.12.2025, për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të B. Divjakë, nj Adm + Inst. në varësi për vitin 2026.
Për këtë pikë Kryetarja ia jep fjalën për relatim Drejtorit të Financës dhe Buxhetit z. Xheladin Brahkola. Drejtori i financës i propozon këshilltorëve të miratojnë ndryshimin e disa niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë, përkatësisht sipas pozicioneve të propozuara në lidhjen bashkangjitur projekt vendimit dhe kryesisht janë 12 pozicione. Propozoi gjithashtu që efektet financiare për këto ndryshime të fillojnë nga data 01.03.2026.
Pyetje nga këshilltarët nuk ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e trembëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

14. pika e katërmbëdhjetë e rendit të ditës.
- Për miratimin e një shtese në Buxhetin e vitit 2026 nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2025.
Kryetarja znj. Xin Bita ia jep fjalën për relatim z. Xh. Brahkola Drejtorit të Financës dhe Buxhetit. Ky i fundit i propozon këshilltorëve të miratojnë një shtesë në Bux. vitit 2026 nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2025, pas aktrakordimit me Degën e Thesarit Lushnje në vlerën 47,220,127.99 lekë, të cilat ndahen si vijon:
- Nga të ardhurat vendore 46,335,501.85 lekë, nga të ardhurat jashtë limitit 884,626.14 lekë, gjithsej 47,220,127.99 lekë.

Project: Date ...... /...... / ..........

z. Edi miratoje shpenzimet nga të ardhurat e trashëguara sipas programeve, bashkëngjitur këtij projekt vendimi, të miratojë shtimin e limitit për Bashkinë Divjakë në vlerën 45,588,767.99 lekë dhe shtimin e limitit për ASHK në vlerën 1,633,360 lekë. Sqaron shpenzimet zë me zë sipas progres bashkëlidhur pr. vend.
z. Lili Bili pyet mbi detyrimet e prapambetura dhe të një detyrimi gjyqësor në një vlerë të konsiderueshme.
Jep sqarimet përkatëse Drejtori i Financës dhe Buxhetit.
Zj. Lin Bili Kryetarja: A ka Bashkia vendime të tjera që futen në detyrime të prapambetura. Përgjigjet z. Theladin Bashkola duke përmendur disa faturë të palikujduara për efekt të mungesës së dokumentacionit.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e katërmbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

15 - Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës.
- Për dhënien e ndihmës financiare për fermerët që kanë pësuar dëme nga përmbytjet e muajit Janar-Shkurt 2026.
Relaton para këshilltorëve specialisti i emergjencave civile z. Feit Dosja dhe i propozon këshilltorëve të miratojnë akordimin e ndihmës financiare sipas masës së dëmit. Janë gjithsej 41 familje, ku janë dëmtuar si në serra dhe në ushqimin e kafshëve, këto janë: Bledar Kaushin, Remos, 50000 lekë, Kledion Demiri 50000 lekë kavance, Nexhip Kaushin 70000 lekë, Higmet Meçi 60000 lekë, Xhadi Nelezi 50000 lekë Haki Nelezi 50000 lekë, Sedik Kaushin 60000 lekë, Islam Shameti 70000 lekë, Damal Kapo 60000 lekë, Perparim Demiri 50000 lekë, Volter Liko 50000 lekë Andrea Liko 60000 lekë, Afrim Liko 50000 lekë, Kujtim Liko 50000 lekë Bajram Feng 50000 lekë, Mifit Rroko 90000 lekë Elton Siko 80000 lekë, Sifi Kruti 70000 lekë Olisea Bellebani 100000 lekë, Behar Caushi 80000 lekë, Petrit Gizhari 60000 lekë, Supresa Bezhi 100000 lekë, Razim Filja 50000 lekë, Kujtim Kalloshi 100000 lekë, Kesmi Yzeiraj 100000 lekë Feit Kici 70000 lekë, Bardhent Xhaqoli 60000 lekë, Gani Hoxha 50000 lekë, Perparim Sojati 70000 lekë, Sotir Mema 50000 lekë, Nasibi Meta 60000 lekë Xhevat Hoxha 70000 lekë, Eugjen Olldashi 80000 lekë, Rami Xhangolli 50000 lekë, Asqeri Hoxha 50000 lekë, Besnik Jaupi 10000 lekë,

Astrit Gjoupi 100000 lekë, Agim Gjoupi 30000 lekë, Skënder Mali 80000 lekë, Zamir Muça 50000 lekë, Xhevahir Çema 50000 lekë.
Gjithsej fondi është 2,720,000 lekë.
Gjetja z. Ardian Vodo: Si e realizuat mënyrën e inspektimit të familjeve të dëmtuara rreth 120 familje, dhe vendosët që vetëm 41 familje të marrin ndihmë financiare, ndërsa të tjerat mbeten pa u ndihmuar. [illegible] në mënyrë të përgjithshme z. Qemal Dosja duke u shprehur se këto janë më të dëmtuarit në sera dhe ushqim për kafshët.
z. Ardian Vodo: Ronjë fermeri që ka prodhime vetëm në fushë dhe i është përmbytur 100% fruti i mbjellë, janë familje të thjeshta të cilat mbahen me bukë vetëm nga të mbjellat e fushës, përse nuk ndihmohen? A i keni konstatuar të gjitha familjet e dëmtuara. A i keni dhënë ndihmë financiare familjeve që kanë mbjellë vetëm në fushë dhe i janë përmbytur?
z. Gjergji Apolli: Shikoj se i keni ndarë fermerët, keni dhënë ndihmë financ vetëm për sera dhe për ushqim kafshësh, ndërsa përmbytjet e të mbjellave në fushë nuk i keni konsideruar fare. z. Ardian Vodo: Na sillni dokumente vërtetuese për të gjitha familjet e dëmtuara. z. Gjergji Apolli: Për pjesën e dëmtuar çfarë kriteresh keni përdorur? Në Grabjan ka shumë familje ku është përmbytur fruti dhe është zhdukur komplet. Propozoj që ky fond të ndahet në mënyrë të barabartë për të gjitha familjet e konstatuara. z.j. Roza Troshku: Këtë komision unifikuan kush e ngriti? Përgjig. sp. i emergjencave civile z. Qemal Dosja si dhe kryetari i Bashkisë.
z. Shpëtim Shkeshi, diskuton mbi dëmtimet e bazës ushqimore të kafshëve, propozoj që t'i bëhet një kthim listës dhe nëse ka fond të shtohen familjet për ndihmë. Për fondin sqaron Drejtori i financës dhe Buxhetit. z.j. Alketa Çomaku: Për familjet në Grabjan që i është dëmtuar e gjithë sipërfaqja e mbjellë me fruta a do t'i jepet një farë ndihme financiare? Mendoj se duhet rishikuar lista.
Znj. Roza Troshku: Në mbledhjen e kaluar të ... dhe pra propozuam që shtesa fondi dhe të shtohet nr. i familjeve
z. Ardian Vodo: Të shtohet nr. i familjeve dhe fondi,

Project: Date ...../...../........

Përgjigjet Drejtori i Financës dhe i Buxhetit duke u shprehur se ky është fondi rezervë dhe jo fond i emergjencës civile.

Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e 15 e rendit të ditës dhe votohet pa ndryshime me 15 vota pro, 2 vota abstenim dhe 1 votë kundër.

16. Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës.

- Për një ndryshim në VKB nr 90 dt. 29.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të B. Drejtore. Relatori znj. Atalanta Simaku, përgjegjëse pranë Dr. B. Nj. dhe shërb. Brendshme dhe i propozon këshilltarëve që të miratojnë ndryshimin e klasifikimit të nivelit të arsimit për pozicionin përgjegjës sektori pranë Sekt. të Pyjeve dhe Kullotave, nga arsim i mesëm në "i lartë" dhe pagë e pozicionit do të jetë përgjegjës sektori i lartë me 98000 lekë.

Pyetje s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

17. Pika e shtatëmbëdhjetë e rendit të ditës.

- Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2026 në Bashkinë Dropull. Kryetarja znj. Dhi... Bita i jep fjalën për relatim përgjegjëses pranë Drejtorisë B. Njerëz. znj. A. Simaku ku propozon miratimin për 10 punonjës mirëmbajtje të rrjetit ujitës dhe furnizimit me ujë sezonal me kontratë nga 02.03.2026 deri 31.8.2026, të miratojnë 3 punonjës mirëmbajtje dhe pastrimi me kontratë 3 mujore nga 01.6.2026 deri më 31.8.2026 si dhe të miratojnë 6 punonjës sezonal në A.Sh. Zjarr. nga 01.6.2026 - 31.8.2026.

Pyetje s'ka diskutime s'ka, Hidhet në votim pika e shtatëmbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë vot abstenim.

18. Pika e tetëmbëdhjetë e rendit të ditës.

- Për transferimin e fondeve nga Buxheti i Bashkisë në shoqërinë "Rrjeta shpk".

Relatori z. Xh. Brahkolli ku propozon që të miratohet transferimi i fondeve sipas aktiviteteve - Fonde për pagë

dhe sig. Shop, karburant, shp. të tjera me vlerë 31,853,130 lekë. Këto të ndara: Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve 24,700,742 lekë; Administrimi i varrezave, kullës dhe tregjeve të lira 7,152,388 lekë. - Ecuria e pagesave të përgjithshme për tu arketuar nga "Rajoni shpk" 10,000,000 lekë. Fondet që transferohen nga Buxheti i Bashkisë në shoqërin "Rajoni" shpk janë me vlerë 21,853,130 lekë.
Pyetje 2. G. Apolli: A do të përdorin tarifat më të larta?
Pyetje zj. Ani Biti: Në mbledhjen e parë thatë se do të monitorojmë, A keni ngritur komision monitorimi?
Përgjigjet drejtori i financës dhe Buxhetit. Pyetje të tjera s'ka. Diskutime s'ka. Hidhet në votim pika e tetëmbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.
19. Pika e nëntëmbëdhjetë e rendit të ditës.
- Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Bashkisë për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit për funksionin e SKB për shkak të plotësimit të moshës së daljes në pension (për herë të dytë).
Relator z. Andi Bulloni, vetë kërkesës drejtuar këshilltarëve. Ndërhyn Kryetari i Bashkisë duke u shprehur se ia kemi sqaruar Kryetarkës së Këshillit këtë kërkesë. Kryetarja zj. Ani Biti: Ju lutem, se nuk po sillemi në etik, dhe e keni përsëritur për të disatën herë këtë shprehje të filmit të Ahe Ikos, këtu jemi në mbledhjen e KB, ku vendosim dhe marrim vendime. Pas leximit të kërkesës nga ana e z. A. Bulloni, Kryetarja propozoi që lirimi nga detyra e SKB të bëhet me votim të fshehtë. Hidhet në votim propozimi dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim. Kryetarja thërret Komisionin e votimit të përbërë nga z. Gazmend Apolli Kryetar, zj. Adelajda Culi zv Kryetare dhe z. Julian Vrapi sekretar. për fillimin e procedurës së votimit të fshehtë. Mblidhet Komisioni i votimit, firmos fletët e votimit dhe fillon procesi i votimit të fshehtë, për lirimin nga detyra e SKB nga anëtarët e Këshillit.
Gjatë procesit të votimit Kryetari i Bashkisë i drejtohet Këshilltarëve duke u shprehur me zë të lartë: "Unë do t'ia ndërpres marrëdhëniet financiare sekretarit të Këshillit të Bashkisë.
Pas kryerjes së votimit, Kryetari i Komisionit të votimit z. Gazmend Apolli lexon Procesverbalin

për votimin dhe numërimin e votave për lirimin
nga detyra e Sekretarit të Këshillit të Bashkisë
dhe vijën.
Nga verifikimi i fletëve të votimit rezulton se: Në votim
morën pjesë 17 Këshilltarë, Fletë votimi të gjetura
në kuti janë 17, Fletë votimi të vlefshme 17, fletë
votimi të pavlefshme 0 (zero) asnjë. Nga procesi
i numërimit të votave për lirimin nga detyra e SKB
rezulton se znj. Mimoza Thomaj ka marrë 4 vota pro,
3 vota abstenim dhe 10 vota kundër. Komisioni
vendosi që znj. Mimoza Thomaj të mos lirohet nga detyra.
20. Pika njëzet e rendit të ditës (pika shtesë në rendin
e ditës).
- Për miratimin e një rishpërndarje fondesh në Buxhetin
e vitit 2026. Në këtë pikë largohet këshilltarja E. Kredhi.
Kryetarja znj. Dini Bitri ia jep fjalën për relatim Drejtorit
të Financës dhe Buxhetit z. Kh. Brahkola, i cili i
propozon këshilltarëve që të miratojnë rishpërndarjen e
fondeve në Buxhetin e Bashkisë për investimet sipas
kapitujve, programeve dhe llogarive, miratuar sipas VKB
nr 87 dt. 29.12.2025.
Kjo rishpërndarje do të kryhet bazuar në nevojat e
Bashkisë Divjakë për investime.
Nga projekti 1470123 – Blerje tuba të brinjëzuar për
KUB dhe KU2, Bashkia Divjakë, programi 4520, mbeten
për rishpërndarje 1,884,000 lekë nga kap. 05 të cilat do të
rishpërndahen me miratim nga KB sipas nevojave të paraqitura.
Nga Buxheti është Blerje tuba të brinjëzuar KUB + KU2,
të Bëhet: Blerje Programi kompjuterik për Drejtorinë e
taksave dhe të ardhurave vendore Bashkia Divjakë.
Kryetarja: A keni pyetje apo diskutime rreth projekt
vendimit shtesë në rendin e ditës?
Pyetje nga këshilltarët nuk ka.
Diskutime për këtë pikë nuk ka.
Hidhet në votim pika e 20, pika shtesë e rendit
të ditës dhe votohet me 16 vota pro, asnjë votë
kundër dhe asnjë votë abstenim.
Të tjera: z. Ardian Vodo: Në fshatin Bicykes, ka
ndodhur një vdekje dhe zonja ka lënë femijët në rrugë

Project: Date ...... /...... / ..........

- Propozoj që të jepet urgjent një ndihmë financiare, familjes e Velfor Dodes.
Këshilltari Bledar Davidhi ngre problematikën e koshave të mbushur me mbetje me javë të tëra të pa zbrazura nga makinat teknologjike të mbetjeve.
Diskutime tek pika të tjera nuk ka.
Kryetarja znj. Lirim Biti e deklaron Mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Divjakë të mbyllur.

Sekretari i KB
Mimoza Nelhomaj

Kryetare e KB Divjakë
Lirim Biti

Roza Troshku

Gojart Agollo

Antuela Guri

Zyjete Mezelli

Bledar Davidhi

Sokol Kaloshi

Gh. Ylberi

Majlinda Xharo

Fatjona Dodani

Nikol... Çeuli

Indrit Zigjani

Adelajda Guli